



Erasmus+



Albanian Erasmus+Office

by

Ms.Edit DIBRA

National Coordinator

International Credit Mobility

for

Students and staff





Erasmus+



KA1 SHKËMBIMET AFATSHKURTRA PËR STAFET DHE STUDENTËT (INTERNATIONAL CREDIT MOBILITY)

Individët duhet të kontaktojnë zyrat e marrëdhënieve me jashtë dhe projekteve pranë universitetit për të mësuar nëse ekziston një projekt shkëmbimesh Erasmus+. Ata duhet të informohen për hapjen e aplikimeve individuale, kriteret e përzgjedhjes, afatet e aplikimit, etj

- Studentët- 3 deri në 12 muaj për studentët në Bachelor, Master, PhD
- pedagogët, stafi administrativ mund të aplikojnë për shkëmbime afatshkurtra, 5 ditë deri në 2 muaj për stafet akademike dhe administrative.
- Kriteret gjuhësore (gjuha dhe niveli i kërkuar) janë përcaktuar në marrëveshjen ndër-institucionale midis dy universiteteve.
- Kriteret e përzgjedhjes për studentët dhe stafet negocohen midis institucionit dërgues dhe atij pritës. Ato duhen bërë publike me hapjen e aplikimeve dhe të shpërndahen në një shkallë sa më të gjerë. (UT hapi aplikimet për shkëmbime me La Sapienza, një IAL polake, letone dhe lituaneze)
- Njohja e periudhës së studimit është kusht i detyruar midis institucionit pritës dhe atij dërgues: Studenti plotëson "Marrëveshjen për kryerjen e studimeve (*Learning Agreement for studies*)
- Institucioni pritës është i detyruar të pajisë studentin dhe institucionin dërgues me listën e notave. Institucioni dërgues duhet të njohë plotësisht modulet që studenti ka kryer gjatë shkëmbimit dhe t'ia regjistrojë ato në listën e notave.



Erasmus+



KA1 SHKËMBIMET AFATSHKURTRA PËR STAFET DHE STUDENTËT (*INTERNATIONAL CREDIT MOBILITY*)

Studenti

- Marrëveshja për kryerjen e studimeve plotësohet nga studenti para mobilitetit, bazuar në modulet/lendet që ai zgjedh të kryejë në universitetin pritës (tabela A). Këto module janë paraqitur në katalogun e vënë në dispozicion nga universiteti pritës. Gjithashtu studenti plotëson tabelën B me modulet/lendet përkuese në universitetin dërgues, të cilat do t'i njihen pas periudhës së shkëmbimit. (Kujdes perputhja)
- Marrëveshja nënshkruhet nga studenti, personi përgjegjës në universitetin dërgues dhe personi përgjegjës në universitetin pritës.
- Dokumentet shkarkohen në gjuhën angleze (CV, ID, Letër motivimi, Diploma për stafin, Certifikata e gjuhës, vertetim për studentin, leter rekomandimi, plani i mobilitetit, lista publikimeve për stafin)

Stafi

Stafi (akademik ose administrativ) në varësi të qëllimit të shkëmbimit plotëson:

- Marrëveshjen e shkëmbimit për mësimdhënie (*Staff mobility for teaching agreement*)
- Marrëveshjen e shkëmbimit për trajnim (*Staff mobility for Training agreement*)

Studenti dhe stafi nënshkruajne:

Marrëveshjen e pjesëmarrjes (*The participant grant agreement*) e cila përcakton kushtet e mbështetjes financiare dhe modalitetet e pagesës. Ky dokument nënshkruhet midis individit dhe institucionit në Vendlindje dhe Programit para fillimit të shkëmbimit.



For more, visit
www.erasmusplus.al

Faqen ne facebook Albanian Erasmus+ Office